



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 94

Ora: 15:50

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 56, DATË 10.05.2023, DEPOZITUAR NGA “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi;

OBJEKT: Kundërshtimin e vendimit nr. 472, datë 09.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja "b", dhe 123/1, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 392 ID, datë 06.05.2023, me denoncues subjektin zgjedhor Koalicioni 'Bashkë Fitojmë'. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se *"Në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, pranë Restorant Balla, Labinot Fushë, në një tabelë është konstatuar afishimi i materialit propagandistik me përmasa të përafërta 10 m të gjatë dhe 3 m të gjërë, në kundërshtim të ligjit dhe udhëzimet e nxjerra prej tij, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë"*.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ ka filluar hetimin administrativ përkatës, duke i kërkuar informacion monitoruesve të caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkisë Elbasan. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka marrë vendimin nr. 472, datë 09.05.2023, ku ka vendosur *'Urdhërimin e Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Elbasan për heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në rrugën nacionale Elbasan-Librazhd pranë Restorant Balla, Labinot Fushë.'*

2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ku pretendon se:
 - *Vendimi i marrë nga KSHZ është bërë duke iu referuar fakteve jo ekzistente dhe duke cenuar të drejtat e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës;*
 - *Në posterin reklamues është vendosur shënimi "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë", në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, si dhe të pikës 1 të nenit 3 të Udhëzimit nr. 06, datë 23.03.2021 të KSHZ "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"*.

3. Seanca e datës 11.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit, specialistëve të administratës së KQZ-së dhe palës ankuese me përfaqësues z. Maringlen Legisi.
4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Vendimin nr. 472, datë 09.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”;
 - Kërkesën ankimore nr. 56, datë 10.05.2023;
 - Shkresën e dërguar nga Policia Bashkiake Elbasan me nr. 2574 prot., datë 11.05.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Me vendimin nr. 472, datë 09.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të vendosura në rrugën nacionale Elbasan-Librazhd pranë Restorant Balla, Labinot Fushë”.
2. Gjatë fazës së shqyrtimit administrativ pranë KSHZ, monitoruesi i caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkisë Elbasan, ka paraqitur informacionin pranë KQZ se materiali propagandistik është vendosur në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd dhe nuk përmban shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...”.
3. Gjatë fazës së shqyrtimit administrativ pranë KAS, përfaqësuesi i subjektit ankues paraqiti si provë materiale disa pamje fotografike të posterit ku dallohej mbi të shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”, ku pretendoi gjithashtu se posterit e përmban shënimin përkatës, por ky shënim është në përmasa shkrimi të vogla.

4. Gjatë shqyrtimit pranë KAS, administrata e KQZ paraqiti shkresën e administruar me nr. 2574 prot., datë 11.05.2023, dërguar nga Policia Bashkiake Elbasan, me anë të së cilës shpjegojnë se është hequr materiali propagandistik objekt shqyrtimi dhe posteritashmë nuk figuron më.

Për këtë arsye, KAS çmon se ankimi mbetet pa objekt, prandaj vendos pushimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 143, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ.
2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

U shpall sot më datë 11.05.2023.

Koli BELE - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**